



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONI RREGULLATOR**

Data:

Nr:

Ora:

**VENDIM**

**PËR**

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.7, DATË 14.2.2025, TË KOMISIONIT RREGULLATOR “PËR MIRATIMIN E KARAKTERISTIKAVE TEKNIKE TË FLETËS SË VOTIMIT PËR ZGJEDHËSIT ME BANIM JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11.5.2025”**

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1 shkronja “g” dhe 3, nenit 25/1, nenit 97 pika 1 dhe nenit 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

**V E N D O S I:**

1. Në lidhjen nr.1, bashkëlidhur vendimit nr. 7, datë 14.2.2025, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11.5.2025”, tek elementët e veçantë dallues në fletën e votimit për votuesit jashtë territorit të RSH, pas paragrafit të fundit të tekstit që përmban Lidhja, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Ngjitur me çdo njërin prej shiritave vertikale në gjithë gjatësinë e tyre, shkruhet emri i qarkut të cilit i përket fleta e votimit”.
2. Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO**

**Kryetar**

**Arens ÇELA**

**Anëtar**

**Dritan ÇAKA**

**Anëtar**

**Helga VUKAJ**

**Anëtar**

**Muharrem ÇAKAJ**

**Anëtar**

Data: Nr:  
Ora:



“Për një shtesë në vendimin nr.7 datë 14.2.2025  
“Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të dates 11.5.2025”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONI RREGULLATOR**

**Lidhja 1**

**Disa karakteristika të fletës së votimit për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025**

**Lloji i letrës:**

Letër methurje (Watermark) jo më pak se 90gr/m<sup>2</sup> 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me trashësi 117 micron, me certifikatë origjinë, me mikroprintime, elementë në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

**Dimensionet e fletës së votimit:**

Gjerësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 297 mm

Gjatësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 420 mm

**Specifikime të përgjithshme:**

Stema e Republikës, me ngjyra

Logo KQZ, me ngjyra

Ngjyra e fletës së votimit ngs përpara: kodi i ngjyrës (CMYK): ( C0%, M 11%, Y 36% K 0%)

Kreu i fletës së votimit ku vendosen elementët e përgjithshëm të fletës së votimit është pangjyrosur (e bardhë) me lartësi 30 mm dhe kjo fletë votimi emërtohet “ FLETË VOTIMI NGA JASHTË”

**Qr kodi (elementë të fshehur teknikë në formën e kodeve):**

- Qarku

2 shifra

**Elementë teknikë të lexueshëm në fletën e votimit**

- Qarku

**Elementë të veçantë dallues në fletën e votimit për votuesit jashtë territorit të RSH:**

**Fleta e votimit në pjesën e pasme të saj të ketë si element dallues dy shiritat vertikale secili në pjesët fundore të gjerësisë me trashësi 400 mm me ngjyrë:**

**Kodi i ngjyrës (CMYK): ( C 70%, M 0%, Y 31% K 0%)**

**Ngjitur me çdo njërin prej shiritave vertikale në gjithë gjatësinë e tyre, shkruhet emri i qarkut të cilit i përket fleta e votimit”.**

Data: Nr:  
Ora:



“Për një shtesë në vendimin nr.7 datë 14.2.2025  
“Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të dates 11.5.2025”